



TREPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. _____

Tiranë ___/___/2024

VENDIM

Nr. 9, datë 30.04.2024

PËR
MIRATIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE
TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
PËR TREMUJORIN E PARË TË MBYLLUR NË 31 MARS 2024

Në bazë dhe në zbatim të nenit 52 pika 1, shkronja “l”, nenit 53, pika 5, shkronja “ë”, dhe nenit 62, pika 1 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja “c”, të nenit 8, pika 2, shkronja “l” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18, pika 2 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të miratojë “Pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për tremujorin e parë të mbyllur më 31 Mars 2024”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Sektori i Financës dhe Investimeve.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Donald Duraj

Sekretare

Kryetar

